



Sonte janë luajtur 2 ndeshjet e grupit B, Rusi - Uells dhe Angli - Sllovaki. Fituesja e këtij grupi do të luajë me ekipin tone përfaqësues në rast se ajo arrin të kualifikohet me tej.

Uellsit ka fituar me rezultatin e thellë 3 - 0 kundër Rusisë. Golat për ekipin e Uellsit janë shënuar nga Ramsey, Taylor dhe i zakonshmi Bale. Me këto fitore Uellsit shkon në kuotën e 6 pikëve, ndërsa Rusia ngelet me 1 pikë duke u eliminuar nga France 2016. Ndeshja tjetër e këtij grupi Angli - Sllovaki ka përfunduar me rezultatin e bardhë 0-0. Anglezet nuk kanë arritur të shënojnë në portën e sllovakeve të cilët me këto barazime kanë ngrumbulluar 5 pikë duke u renditur të dytë. Ndërsa ekipi sllovak ka arritur të grumbullojë 4 pikë dhe të renditet në vendin e 3-të. Me shumë mundësi Sllovakia do të vazhdojë me tej si një ndër 4 ekipet e treta me të mira. Për fat të keq këto rezultate nuk kanë qenë në favor të Shqipërisë por shpresa për kualifikim ngelet akoma. Në rast kualifikimi Shqipëria ka mesuar kundërshtarin e saj në 1/8.